



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DIBËR  
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

2022

Nr. \_\_\_\_\_ Prot

Peshkopi, më 09.06.2022

Lënda: Dërgim vendimi

Drejtuar: Prefekti i Qarkut Dibër

Bashkëngjitur po ju dërgojmë për konfirmim Vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër Nr.40

**Date 03.06.2022**

“Për dhenien e ndihmës ekonomike për muajin Prill 2022, familjeve në nevojë që janë përjashtuar nga sistemi për arsye të plikëzimit, duke përdorur fondin e kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6%, i ndryshuar”.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Sekretari i Këshillit Bashkiak

**Afrim Miki**





1004/10706/22

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT DIBËR

Nr.529/1.prot.

Peshkopi, më 10.06.2022


Lënda : Per vendimin nr. 40, datë 03.06.2022 të Këshillit të Bashkisë Dibër

Drejtuar : BASHKISË DIBËR

PESHKOP I

Në mbështetje të ligjit nr.107/2016, date 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, neni 16, pasi verifikova për efekt ligjshmërie vendimin e Këshillit të Bashkisë Dibër nr.40, date 03.06.2022 “Për dhënien e ndihmes ekonomike me fondin deri 6% për muajin prill 2022”, konstatova se:

Akti administrativ objekt verifikimi dhe shqyrtimi bën pjesë në kategorinë e akteve me karakter individual për pasojë hyrja në fuqi e tij nuk kushtezohet nga firmimi apo kunderfirmimi i Prefektit por sipas parashikimit të paragrafit të fundit të nenit 55/6 të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, që kurdohet është përgjegjësi direkte administrativo-ligjore e strukturës së posaçme të Bashkisë Dibër që paraget për miratim projekt akte të kësaj natyre.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DIBËR  
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

VENDIM Nr. 40 Datë 03.06.2022

“PËR DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE PËR MUAJIN PRILL 2022, FAMILJEVE NË NEVOJË QË JANË PËRJASHTUAR NGA SISTEMI PËR ARSYE TË PIKËZIMIT, DUKE PËRDORUR FONDIN E KUSHTËZUAR PËR BLOK-NDIHMËN EKONOMIKE DERI NË 6 PËRQIND, I NDRYSHUAR”

Në mbështetje të nenit 21, të ligjit nr.9355, datë 10.03.2005 dhe VKM 957. Date 04.09.2019. “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, të Kreut IV, pika 2 të vendimit nr 955, date 07.12.2016, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfuturit të ndihmës ekonomike”, të ndryshuar dhe Udhëzimit nr.5, datë 17.02.2017 “Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6 përqind”, i ndryshuar dhe në Udhëzimin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr 1190/1 prot, datë 23.02.2018 “Për përdorimin e fondit deri në 6%”, Këshilli Bashkiak Dibër në mbledhjen e datës **03.06.2022** miratoi me 19 vota pro 3 kundër 0 apstrenim 6% e muajit Prill 2022.

**VENDIM:**

1. Miratimin e dokumentacionit për dhënie e ndihmës ekonomike për muajin Prill 2022 **475** familjeve në nevojë me fond **2.280.328** të cilat janë aplikuese në sistemin e nd.ekonomike, por nuk janë shpallur fituese.
2. Këto familje janë të përzgjedhura nga njësitë administrative sipas kriterëve të përcaktuara me ligj.
3. I bashkangjitet këtij vendimi lista emërore me shumën përkatëse sipas Njësiive Administrative.
4. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet sektori i ndihmës ekonomike dhe sektori i financës.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
6. Vendimi u shpall sot më datë 03.06.2022.

Kryetar Këshilli

Sokol Sara

